

STATUTI

SHOQERISE TREGTARE "NER TRAVEL" sh.p.k

DISPOZITA TE PERGJITHSHME FORMIMI I SHOQERISE

Neni 1

Në datën 04.01.2024 themelohet shoqëria tregtare me përgjegjesi të kufizuar e emertuar "NER TRAVEL" sh.p.k. me vullnetin e lirë të ortakëve . Shoqëria me përgjegjesi të kufizuar "NER TRAVEL" sh.p.k. formohet nga ortaku themelues:

Rafaello Kafilaj i datelindjes 30.11.2000 me ID K01130078C me përgjegjesi juridike e të plote për të vepruar

Me vullnetin e tij të lirë dhe në përputhje me Ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ortakët kanë vendosur ta destinonjë këtë sipërmarrje në kapitalin e tyre, me qëllim që të përfitojnë të ardhurat që mund të vijnë nga veprimtaria private e Shoqërisë, si dhe të përballojë humbjet deri në kufirin e vlerës së kontributit në Kapitalin Themeltar.

Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në baze të ekonomisë së tregut të lirë.

FORMA DHE EMERTIMI I SHOQERISE

Neni 2

1. Shoqëria tregtare është e organizuar si Shoqëri me Përgjegjesi të Kufizuar.
2. Emertimi i Shoqërisë është: "NER TRAVEL" sh.p.k.
3. Në rast transferimi të veprimtarisë tregtare mund të ruhet i njëjti emërtim.

SELIA E SHOQERISE

NENI 3

1. Shoqëria ka selinë qendrore në territorin e Republikës së Shqipërisë. Vlorë, Lagjia Bashkimi, Rr Gjergj Kastrioti, Ap 21, Kati i parë, nr. 4/213+1-n18, 9404
2. Shoqëria mund të krijojë filiale, zyra përfaqësimi apo agjensi në qytete të tjera të Shqipërisë ose jashtë vendit.
3. Ajo mund të jetë pjesëmarrëse në një shoqëri tregtare apo mund të kontrollojë shoqëri të tjera tregtare si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
4. Shoqëria do të ketë vullnetin e saj.



KOHEZGJATJA

Neni 4

1. Shoqëria do të permbushë objektin e veprimtarisë së saj me një afat të pacaktuar.
2. Ndryshimet e shoqërisë duke përfshirë edhe përcaktimet e mëvonshme në lidhje me kohezgjatjen e aktivitetit të saj sjellin si pasoje krijimin e një Personaliteti të ri Juridik.

OBJEKTII VEPRIMTARISE

Neni 5

Objekti i shoqërisë do të jetë

Sherbime në fushën e turizmit, udhetime turistike, transport udhëtarësh kombëtar dhe ndërkombëtar, makina me qera, riparime dhe sherbime mekanike, bar restorant.

TE DREJTAT E SHOQERISE

Neni 6

Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet që rrjedhin nga veprimtaria ekonomiko-tregtare apo industriale që ortaket zhvillojnë në mënyrë të pavarur prej saj.

Shoqëria mund të ndryshojë emrin, seline, kohezgjatjen, objektin e veprimtarisë, administratorin, kjo sipas vendimeve që do të marrin ortaket e saj.

KAPITALI I SHOQERISE

Neni 7

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 100000 (njëqind mijë lekë) , i cili është teresisht kapital financiar. Kapitali themeltar është i ndarë në 1 kuotë zotëruar konkretisht nga ortaku:

Rafaelo Kafilaj i datelindjes 30.11.2000 me ID K01130078C, 1 kuotë në masën 100% me vlerë 100000 lekë.

Ortakët kanë të drejtë të tjetërojnë të zmadhojnë apo të pakësojnë kapitalin deri në kufinjtë e përcaktuara nga ligji.

NENI 8

Shoqëria krijon fondin rezerve dhe fonde të tjera të vecanta të financimit për zhvillimin ekonomik e tregtar.



NENI 9

1. Perberja e kapitalit te shoqerise, fondet e krijimit te saj si dhe perdorimi dhe rregullimi i cdo fondi te vecante percaktohen nga Ortaku/et sipas te drejtave dhe detyrave te percaktuara ne statut.
2. Te ardhurat e pergjitheshme te shoqerise dhc në pergjithesi çdo operacion financiar i saj do te pasqyrohet ne kontabilitetin e shoqerise sipas legjislacionit ne fuqi dhe ne mbeshtetje të akteve perkatese te rrjedhura prej tij.

NENI 10

1. Shoqeria Tregtare eshte pronare e pasurise se saj te cilen e perdor dhe e disponon ne emer te saj ne perputhje me qellimin dhe objektin e vcprihtarise se shoqerise.
2. Shoqeria eshte e lire te bleje dhe te shfrytezoje te drejta te tjera materiale ne perputhje me legjislacionin perkates shqiptar.
3. Te gjitha shpenzimet per ushtrimin e aktivitetit tregtar, asistence teknike e juridike paguhen nga fondet e shoqerise.

NENI 11

1. Pasurite e shoqerise vleresohen ne monedhe shqiptare.
2. Aktiviteti financiar i shoqerise do te mbyllet me 31 Dhjetor te çdo viti dhe bilanci do te miratohet brenda tre muajve te vitit ne vazhdim.(ne zbatim te ligjit)
3. Llogarite vjetore, inventari, raportet dhe operacionet e vitit financiar, raportet e vecanta te hartuara nga Ortaket dhe nese e kerkon ligji nga eksperti kontabel i autorizuar, miratohen me Vendim te Ortakut/eve të saj.

NENI 12

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht të transferueshme ne rruge trashegimie. Ato jane lirisht te transferueshme dhe ne rast ndarje pasurore midis bashkeshorteve si dhe ndermjet pasardhesve dhe paraardhesve.

NENI 13

Transferimi i pjeseve te kapitalii themeltar me trashegimi ose brenda familjes personave perfitues do te behet pasi ata te pranojnë pcrmbajtjen e statutit i kesaj shoqerie tregtare me gjithë ndryshimet qe ai mund te kete pesuar deri ne momentin qe keto pjese te kapitalit themeltar behen te transferueshme.



NENI 14

Në rast mospranimi, pjesët e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri vetëm me miratimin e Ortakeve.

NENI 15

Zmadhimi i kapitali themeltar me anën e kontributeve në para dhe në natyrë apo dhe zvogelimi i tij bëhet me Vendimin e ortakut/eve të shoqërisë mbi bazën e një projekti të paraqitur nga ekonomisti i firmës ose kontabli i miratuar.

KREU I DYTE

ORTAKET

NENI 16

Ortaku/ket e shoqërisë tregtare gëzon të gjitha të drejtat dhe merr pjesë për detyrimet që pasqyrohen në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë si dhe në Statutin e Shoqërisë.

Drejtat dhe detyrat e Ortakeve

NENI 17

1. Të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblese së Ortakeve duke ushtruar të drejtën e votës së tij;
2. Të paraqesë pyetje me shkrim në lidhje me aktivitetin dhe administrimin e shoqërisë ndaj administratorit;
3. Të informohet mbi përmbajtjen e raportit të administrimit, inventaret e llogarite vjetore, tekstet e vendimeve të propozuara, dhe raportin e ekspertit kontabel;
4. Të përfitojë nga fitimi i shoqërisë;
5. Të kërkojë prishjen e shoqërisë në rrethana të caktuara;

KREU I TRETE

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

NENI 18

1. Sipas nevojave që paraqiten për zhvillimin e aktivitetit të shoqërisë, asambleja e ortakëve emëron dhe punëson administrator dhe drejtues teknik, të cilët qëndrojnë në detyrë deri sa revokohen nga shoqëria ose largohen me dëshirën e tyre. Administratori i emëruar i ka të



- gjitha kompetencat për të vepruar në emër të shoqërisë me përjashtim të rasteve të vecanta që ligji i jep shprehimisht ortakeve të shoqërisë.
2. Shoqëria do të administrohet nga administratori Rafaelo Kafilaj i datëlindjes 30.11.2000 me ID K01130078C i cili do të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhëniet me të tretet për një periudhë 5 (pese) vjetë me të drejtë rizgjedhje.
 3. Administratori mund t'i delegojë kompetencat e tij me shkrim në formën e autorizimit ose me prokurë.
 4. Shoqëria në të ardhmen mund të administrohet edhe nga një administrator tjetër i cili emërohet me Vendim të Asamblesë së Ortakeve.

NENI 19

1. Asambleja e Ortakut\ve është organi më i lartë vendimarrës i shoqërisë.
2. Ortaket mund t'i delegojnë kompetencat e tyre me shkrim në formën e autorizimit ose me prokurë.
3. Çdo klauzole e kundërt është e pavlefshme në këtë rast.

NENI 20

Asambleja e Ortakeve ka të drejtë

1. Të hartojë e miratojë ndryshimet në Statut;
2. Të miratojë bilancin vjetor të shoqërisë;
3. Të vendosë për zmadhimin apo zvogëlimin e kapitalit themelues të shoqërisë;
4. Të çmërojë dhe shkarkojë administratorin e shoqërisë;
5. Të shpallë prishjen, likuidimin dhe falimentimin e shoqërisë;
6. Të shprehet për kohezzgjatjen e shoqërisë;
7. Të miratojë marrëveshjet e arritura në qarkullimin civil të saj;
8. Të miratojë strukturat e shoqërisë etj.;

Proccs verbalet e mbledhjeve ruhen në selinë e shoqërisë.

TE DREJTATE ADMINISTRATORIT

NENI 21

Administratori ka këto të drejta:

1. Të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhëniet e saj me të tretët e në administratën publike;



2. Të emeroje prane shoqerise personelin e domosdoshem qe i nevojitet asaj ne permbushjen e aktivitetit tregtar dhe ekonomik;
3. Të paraqesë për miratim ne Asamblene e Ortakeve strukturen e brendshme organizative te shoqerise me emra perkates dhe te permbushe te gjitha detyrimet ligjore qe rrjedhin nga legjislacioni i punes i Republikes se Shqiperise;
4. Të administroje pasurinë dhe mjetet financiare të shoqerise brenda kufijve te caktuara nga Asambleja e Ortakeve;
5. Të testoje aftesite e punonjesve ne administrate;
6. Të therrasë Asamblenc e Ortakeve dhe të propozoje çështjet qe duhen analizuar;
7. Të hartojë objektivat e shoqerise per cdo vit pasues dhe të vendose e te ndjeke realizimin e detyrave te lena nga Vendimet e marra nga Ortaket;
8. Të hartoje planet e llogarive ekonomike dhe t'i paraqese ato per miratim nga Asambleja e Ortakeve.

NENI 22

Administratori eshte pergjegjes individualisht sipas rastit ndaj vete shoqerise ose ndaj te treteve per shkelje te ligjeve. per shkelje te Statutit apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

NENI 23

1. Shoqeria organizon kontrollin e brendshem me ekonomist te licensuar dhe kur kerkohet nga ligji me nje ekspert kontabel te autorizuar te cilct jane pergjegjes per problemet qe mund te shkaktone nga moskryerja ne rregull e detyres se tyre.
2. Per emerimin, kompetencat, detyrimet. Pergjegjesite, zevendesueshmerine, terheqjen, shkarkimin dhe shperblimin e tij bazohet tek legjislacioni Shqiptar ne fuqi.

NENI 24

1. Te gjithë personat qe do te punesohen prane kesaj shoqerie, për punesimin e tyre do te zbatohet mbi bazen e kontratës individuale apo kolektive, sipas rastit, ne te cilcn do te pcrckaktohen te drejtat dhe detyrimet ligjore te seciles pale si dhe paga mujore në perputhje me legjislacionin shqiptar ne kete fushe.
2. Marrja ne pune bëhet me rregjistrimin nga punedhenesi në Librin e Punes se Shoqerise. si dhe duke njoftuar organet e Punes se Juridiksionit ku ushtron aktivitetin Shoqeria.



3. Ndryshimi dhe largimi nga vendi i punes. behet ne baze te nje akti me shkrim të leshuar nga Administratori. Largimi lidhet me mbarimin e kontrates se punes per shkak te shkeljeve disiplinore ose me kerkesen e te interesuarit.
1. Mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate veprimtarise se Shoqerise, do te zgjidhen me mirekuptim te paleve, te cilat per kete qellim mund te caktojne nga nje perfaqesues me prokure. Kur mirekuptimi nuk eshte i mundur palet i drejtohen Gjykates te Rrethit GjyqSsor.

FORCAT MADHORE

NENI 25

Ortaket nuk mbajne pergjegjesi kur ka paaftesi paguese pjesore apo te plote per kryerjen e detyrimeve te tij kur kjo është si pasoje e rrethanave te foreave madhore qe vertetohen pas nënshkrimit te kontrates dhe ortakët nuk mund ti shmangen me masa te arsyeshme.

Ngjarje te forrcave madhore jane ato qe i shpetojne kontrollit të ortakeve.

Kur ortakët ndodhen në paaftesi ti plotesojne detyrimet e tyre per arsye te foreave madhore ne baze te kontrates dhe statutit duhet te bejnë çdo perpjekje qe ta kapercenje këtë vështirësi.

SHPERNDARJA E SHOQERISE

NENI 26

Shperndarja e shoqerise mund te vije në cdo kohe dhe per çfareado shkak.

Shoqeria mund te priset para kohe;

-Me vendim te ortakeve

-Kur mbaron kohezgjatja e shoqerise.

-Pas dy vjeteve të veprimtarise me bilanc negativ.

-Me vendim te gjykates ose per arsye te tjera te parashikuara ne statut.

-Me fillimin e procedures se falimentimit sipas ligjit te Falimentimit.

Në rast mbyllje ortakët vendosin mbi mënyrat e likujdimit dhe caktojnë një ose me shume likujdatore duke ju percaktuar dhe detyrat. Ne rastin të likujdimit emertimi i shoqerise do te shoqerohet nga shenimi "Shoqeri ne likujdim".(referuar ligjit ne fuqi)

Mbasi behet njoftimi i mbylljes se likujdimit dhe kryen formalitetet e duhura shoqeria çregjistrohet nga rregjistri tregtar i Qëndrës Kombetare të Biznesit.



BAZA LIGJORE

Neni 27

E gjithë veprimlaria e shoqërisë do të bazohet në ligjin 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar si dhe në përgjithësi në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

RUAJTJA E SEKRETIT

Neni 28

Ortakët detyrohen që të mos nxjerrin tek të tretet të dhëna dhe njortime sekrete që kanë të bëjnë me veprimtarinë ekonomike të shoqërisë.

Ortakët e shoqërisë përcaklojnë llojin e të dhënave dhe informatave që konsiderohen sekrete.

DISPOZITA TE FUNDIT

NENI 29

Për sa nuk është parashikuar në këtë Statut do të aplikohet Ligji "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, si dhe legjislacioni Shqiptar në fuqi.

NENI 30

Ky Statut hyn në fuqi ditën e regjistrimit të shoqërisë në Rregjistrin Tregtar në Qendrën Kombëtare të Biznesit

NENI 31

Ky Statut përpilohet sot me datë 04.01.2024

ORTAKU I SHOQËRISE NER TRAVEL sh.p.k.
Rafaello Kafilaj

Rafaello Kafilaj

